



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 209/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi kryesues, Nenad Laziq dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e Levizjes Vetëvendosja (LVV) dega në Prizerën, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike Kosovës (PDK), për shkak të vendosjes së posterave në objekte publike, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 17.10.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Levizjes Vetëvendosja LVV, dega në Prizeren .

Arsyetim

Me datën 08.10.2013, Lëvizja Vetëvendosja, ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën ankesë pretendon se, me datë 08.10.2013, antarë të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) kanë vendosur material zgjedhor në objektin e Asamblesë Komunale në Prizeren me që rastë konsiderojn se është bërë shkelje e nenit 33 pika b të Ligjitë për Zgjedhjet e Përgjithshme neni 3 pika b e Kodit të Mirsjelljes për subjekte politike dhe neni 3.4 të rregullës Zgjedhore 13/2013.

Në cilësinë e provës, parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur dy fotografi si dëshmi.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik më datën 09.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 10.10.2013 deri në ora 12:00.

Sipas afatit të caktuar PZAP-i pranoi përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik PDK me të cilën konsideron se janë të pabaza pretendimet e LVV, lidhur me shkeljen e rregullave të përcaktuara në nenin 33 pika b. të LZP –së, neni 3 pika b e Kodit të Mirsjellje së subjekteve politike sipas të dhënave që kemi nga terreni, dhe fotografive të deponuara nga pretenduesi, nuk shihet qarë se ku janë të vendosura këto simbole të PDK, dhe se këto me asgjë nuk përputhen me pretendimet e Levizjes Vetëvendosje.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Pretendimet e parashtruesit te ankesës se subjekti politik PDK ka vendosur materialin zgjedhor në objektin e Asambles Komunale në Prizeren , nuk qëndrojnë ngase nga dëshmitë e ofruara nga parashtruesi i ankesës nuk mund te vihet në dyshim se është kryer një veprim i tillë, për arsye se nga fotografitë e ofruara si provë nga LVV, nuk mund të identifikohet objekti për të cilin pretendohet ne ankese.

PZAP-i, konstatoi se një pretendim i tillë është i përgjithshëm dhe i pa qartë për tu administruar si provë relevante nga fotografitë e paraqitura si dëshmi, prandaj ankesa vlerësohet si e pa bazë duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, dhe në kuptim të nenit 115.1, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 209/2013 më datën 17.10.2013.

Kryesuesi i Panelit
Nehat Idrizi



Udhëzim Juridik:

PZAP-i nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*